



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
-Këshilli Drejtues-

---

**V E N D I M**

**Nr.1027, date 06.11.2009**

**Për**

**amendimin e Autorizimit Individual te sipërmarrësit “F.P.M.” sh.p.k. të miratuar me VKD nr. 694 date 12.02.2009 duke e pajisur sipërmarrësin “F.P.M.” sh.p.k me Autorizim Individual për një sistem radioalarmi ne brezin VHF, me zone gjeografike qyteti Vlore 15 – km.**

Këshilli Drejtues i Autoritetit te Komunikimeve Elektronike dhe Postare në mbledhjen e datës 06.11.2009, sipas rendit te ditës dhe procedurës se përcaktuar ne nenin 7 e ne vijim te Rregullores se Brendshme ne fuqi, miratuar me Vendim te Këshillit Drejtues nr. 170, date 24.04.2004, e ndryshuar me Vendim te Këshillit Drejtues Nr. 452, date 02.05.2008, bazuar ne ligjin Nr. 9918, date 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë*”, neni 115 “*Marrja e Vendimeve dhe Struktura e Këshillit Drejtues*”, mori në shqyrtim:

- Propozimin e Drejtorisë së Licensimit për miratimin e kërkesës se sipërmarrësit “**F.P.M.**” **sh.p.k.** për caktim frekuencash sipas rregullores per Autorizim Individual.

**BAZA LIGJORE :**

- Ligji Nr. 9918, date 19.05.2008 “*Për Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqipërisë*”, neni 8, pika g, nenet 62 deri 79 te ligjit 9918 date 19.05.2008;
- Neni 8, neni 121, pika 1, neni 122, pika 2, germa b, neni 124, neni 125 dhe neni 128 i Ligjit 8485, date 12.05.1999 “*Kodi i Procedurave Administrative*”.
- Rregullorja për Autorizimin Individual miratuar me VKD nr. 510 date 04.11.2008;
- Autorizim Individual te sipermarresit “**F.P.M.**” **sh.p.k.** te miratuar me VKD nr.694, dt.12.02.2009.

Ne përfundim te interpretimit te bazës ligjore, materialit te paraqitur dhe kërkesës se sipërmarrësit te lartpërmendur

**VËREHET SE :**

Sipermarresi “**F.P.M.**” **sh.p.k.** eshte pajisur me Autorizimin Individual te miratuar me VKD nr.694, dt.12.02.2009, per perdorimin e frekuencave, per sistem radiokomunikimi me zone gjeografike qyteti Vlore – 15 km. Sipërmarrësi ka kryer likuidimet përkatëse dhe është pajisur me AI sipas vendimit.

Me shkresen nr.3974, date 16.10.2009, kërkesë për caktim frekuencash sipas rregullores per Autorizim Individual, ka kërkuar te shtoje sistem radioalarmi ne brezin VHF, me zone gjeografike qyteti Vlore 15 – km.

Drejtoria e Rregullimit Teknik me shkresën nr.3974/1, dt.27.10.2009, ka konfirmuar te dhënat teknike për këtë subjekt.

Sipërmarrësi ka kërkuar qe vlefshmëria e Autorizimit Individual te jete per 3 vjet.

Në përfundim të interpretimit të bazës ligjore dhe propozimit të Drejtorisë së Licensimit lidhur me kërkesat e sipërmarrësit të sipërcituar, Këshilli Drejtues

### V E N D O S I :

1. Të miratojë kërkesën e sipërmarrësit **“F.P.M” sh.p.k.** per caktim frekuencash ne brezin VHF për sistem radioalarmi, me vlefshmëri 3 vjet, duke filluar nga data \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2009 deri 31.12.2011, sipas aneksit 1/2 bashkelidhur këtij vendimi.
2. Të amendojë Autorizimin Individual te sipërmarrësit **“F.P.M.” sh.p.k.** të miratuar me Vendimin Nr. 694 date 12.02.2009 duke i shtuar aneksit te caktimit te frekuencave për këtë sipërmarrës, aneksin 1/2 bashkelidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohen Drejtoria e Licensimit dhe Drejtoritë e tjera te AKEP për ndjekjen e efekteve qe rrjedhin nga ky vendim.
4. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

### KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

**Ilir SHEHU**

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**

## ANEKS 1/2 – BREZAT VHF, UHF, SHF dhe HF

### Caktim Frekuencash Sipas Rregullores për Autorizimin Individual

#### 1. Te dhenat e sipërmarresit:

1.1	Emri i Personit Fizik/Juridik	F.P.M sh.p.k
1.2	Adresa Postare	Pallati Kultures “Laberia”, Vlore
1.3	Telefon/Faks/E-mail	0692084983
1.4	Personi i Kontaktit	Flamur Mamaj
1.5	Data e regjistrimit ne QKR	05.11.2008
1.6	NIPT-i	K36504231J

#### 2. Te dhena mbi frekuencat qe caktohen ne VHF:

2.1	Trafiku	Simpleks	
2.2	Tipi i Transmetimit:	Te dhena	
2.3	Brezi i Frekuencave:	VHF : 146.6875 MHz	
2.4	Sistemi:	Radioalarm:	
2.5	Stacioni Radiomarres (Koncentrorit):	Alan RPT 35S	
2.6	Radiodhenasit/ave	Alan DM 110	
2.7	Numri i Pajisjeve	Radiomarres: 1	Radiodhenes: 4
2.8	Gjeresia e Kanalit (KHz):	12,5 KHz	
2.9	Antena	Tipi: GPX 1.8	Perforcimi dB: 3
2.10	Fuqia ne dalje e pajisjes [E.I.R.P] (W, dBw, dBm):	12,5 W / 10 W	

#### 3. Vendndodhja dhe te dhenat e Zones se Mbulimit

3.1	Vendi i Stacionit (Koncentrorit):	Prane Pallatit te Kultures “Laberia”, Vlore	
3.2	Kordinatat Gjeografike:	40°N27’14,70”	19°E29’01,48”
3.3	Lartesia nga Niveli i Detit (metra)	20 m	
3.4	Lartesia nga Toka (metra)	20 m	
3.8	Destinacioni final (Zona Gjeografike)	Qyteti Vlore – 15 km	

#### 4. Koha qe caktohet per perdorimin e frekuencave:

4.1	Koha e Vlefshmerise: 3 vjet	Data e hyrjes ne fuqi: __.__.2009	Data e mbarimit: 31.12.2011
-----	-----------------------------	-----------------------------------	-----------------------------